



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/  
Ministry of Internal Affairs  
**Inspektorati Policor i Kosovës**



# RAPORTI VJETOR 2018



## INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

# RAPORTI VJETOR 2018





## ***MISIONI I IPK-SË***

***MISIONI I INSPEKTORATIT POLICOR TË KOSOVËS ËSHTË QË PËRMES USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË TIJ, TË SIGUROI NJË SHËRBIM POLICOR TË PËRGJEGJSHËM, DEMOKRATIK DHE TRANSPARENT, NË PËRPTHJE ME LEGJISLACIONIN NË FUQI DHE STANDARDET E KËRKUARA.***



# **I. FUSHËVEPRIMI I IPK-SË**

---

## **OBJEKT I VEPRIMTARISË SË IPK-SË ËSHTË:**

- 1. PARANDALIMI, ZBULIMI, DOKUMENTIMI DHE HETIMI I VEPRAVE PENALE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS, PA DALLIM GRADE DHE POZITE GJATË USHTRIMIT SË DETYRËS OSE JASHTË SAJ;**
- 2. INSPEKTIMI I STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE TË POLICISË SË KOSOVËS PËR TË SIGURUAR LLOGARIDHËNIE, EFEKTIVITET DHE EFIKASITET NË ZBATUESHMËRINË E LIGJEVE, AKTEVE NËNLIGJORE DHE PROCEDURAVE STANDARDE TË OPERIMIT NË FUQI;**
- 3. HETIMI DHE/OSE INSPEKTIMI I INCIDENTEVE DISIPLINORE TË PROFILIT TË LARTË, KU PËRFSHIHEN TË GJITHË PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS;**
- 4. HETIMI I TË GJITHA SHKELJEVE DISIPLINORE TË SUPOZUARA TË ZYRTARËVE POLICOR ME GRADËN MË TË LARTË TË NIVELIT TË LARTË TË MENAXHIMIT DHE ZYRTARËVE POLICOR TË NIVELIT TË LARTË EKZEKUTIV;**
- 5. KUR EKZISTON DYSHIMI I BAZUAR SE DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË KA KRYER SHKELJE DISIPLINORE, KRYEMINISTRI MUND TË AUTORIZON IPK-NË PËR ZHVILLIM TË HETIMEVE DISIPLINORE. IPK-JA PAS PËRFUNDIMIT TË HETIMEVE DISIPLINORE I RAPORTON KRYEMINISTRIT PËR TË GJETURAT;**
- 6. PRANIMI I TË GJITHA ANKESAVE TË QYTETARËVE SI DHE SHQYRTIMI DHE PËRCAKTIMI SE CILAT NGA ANKESAT HETOHEN NGA IPK DHE CILAT DO T’U REFEROHEN POLICISË SË KOSOVËS APO INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE.**

## II. SHKURTESAT

---

<b>AKSP</b>	<b>Akademia e Kosovës për Siguri Publike;</b>
<b>DFSHP</b>	<b>Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme;</b>
<b>DPP</b>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë;</b>
<b>DRP</b>	<b>Drejtoria Rajonale e Policisë;</b>
<b>DRPK</b>	<b>Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare;</b>
<b>DH</b>	<b>Departamenti i Hetimeve;</b>
<b>EPAC</b>	<b>European Partners Against Corruption</b>
<b>EULEX</b>	<b>Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë;</b>
<b>EVS</b>	<b>Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi</b>
<b>ICITAP</b>	<b>Internacional Criminal Investigative Training Assistance Program;</b>
<b>IPK</b>	<b>Inspektorati Policor i Kosovës;</b>
<b>MPB</b>	<b>Ministria e Punëve të Brendshme;</b>
<b>NJHDPK</b>	<b>Njësia e Hetimeve të Drejtorisë së Policisë Kufitare;</b>
<b>NJHR</b>	<b>Njësia e Hetimeve Rajonale;</b>
<b>OSBE</b>	<b>Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë;</b>
<b>PK</b>	<b>Policia e Kosovës;</b>
<b>PSO</b>	<b>Procedura Standarde të Operimit;</b>
<b>SPK</b>	<b>Stacioni Policor Kufitar</b>
<b>SPMK</b>	<b>Stacioni Policor për Mbikëqyrjen e Kufirit</b>
<b>SHÇBA</b>	<b>Shërbimi për Çështje të Brendshme dhe Ankesa</b>
<b>TI</b>	<b>Teknologjia Informativë;</b>

### **III. PËRMBAJTJA**

---

- I. FUSHËVEPRIMI I IPK-SË**
- II. SHKURTESAT**
- III. PËRMBAJTJA**
- IV. FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV**
- V. HYRJE**
- VI. AKTIVITETET E IPK-SË NË MENAXHIMIN E ANKESAVE**
- VII. AKTIVITETET E IPK-SË NË HETIMET E RASTEVE**
- VIII. AKTIVITETET E IPK-SË NË INSPEKTIMET PERFORMANCËS  
POLICORE**
- IX. AKTIVITETET NË FUSHËN E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN,  
BASHKËPUNIMIN VENDOR E NDËRKOMBËTAR, PLANIFIKIMIT  
STRATEGJIK DHE ÇËSHTJEVE LIGJORE**
- X. MBËSHTETJA E FUNKSIONEVE OPERATIVE TË IPK-së NGA DFSHP-ja**

## IV. FJALA HYRËSE E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

---



Lexues të nderuar,  
Kam kënaqësinë, që përmes këtij Raporti Vjetor, të shpalosë angazhimet e strukturës operative dhe mbështetëse të Inspektoratit Policor të Kosovës për vitin 2018. Në këtë raport paraqiten rezultatet dhe të arriturat e punës sonë, si dhe sfidat që na kanë përcjellë përgjatë vitit që lamë pas.

IPK ka vazhduar përkushtimin e saj në ngritjen e efikasitetit në fushën e përmbushjes së mandateve ligjore, po ashtu edhe në fusha tjera, përfshirë ngritjen e kapaciteteve operacionale, thellimin e bashkëpunimit me institucionet, promovimin dhe sensibilizimin organizativ, ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies, etj.

Në përmbushje të mandateve ligjore dhe falë ngritjes së besueshmërisë së qytetarëve, është ngritur numri i ankesave të adresuara në IPK mbi dyshimet për shkelje të rregullave policore nga radhët e punonjësve policor. Hetuesit e IPK-së kanë trajtuar me seriozitet të shtuar rastet në kompetencë të departamenteve operative. Në drejtim të fuqizimit të integritetit policor, IPK ka realizuar edhe një numër inspektimesh, të cilat kanë rezultuar edhe me një ngritje të numrit të rekomandimeve.

Përgjatë tërë vitit është shënuar një thellim i bashkëpunimit me mekanizmat ndër-institucional dhe ata ndërkombëtar, duke veçuar bashkëpunimin me Prokurorin e Shtetit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Avokatin e Popullit, Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe Policinë e Kosovës. Roli i ICITAP-it dhe OSBE-së, vazhdon të mbetet prioritar në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike. Mbështetja e këtyre mekanizmave ka përfshirë fushat e ngritjes së kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve, por edhe realizimit të projekteve teknike.

Falë Memorandumit me SHÇBA-në, janë shkëmbyer përvojat e dyanshme operacionale lidhur me fushat, që përcaktohen brenda mandateve ligjore të dy organizatave homologe. Ky vit ka shënuar progres edhe në ngritjen e bashkëpunimit me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Republikës së Maqedonisë, ku falë Protokollit të Bashkëpunimit të Ministrive të Brendshme të të dyja vendeve, presim koordinimin e aktiviteteve në drejtim të zhvillimit të policive të vendeve tona, krahas standardeve evropiane. Pjesëmarrja në konferencat e përvjetshme të EPAC-ut, shënon përafrimin e IPK-së me institucionet simotra evropiane, drejt shkëmbimit të përvojave në fushën e



hetimeve, inspektimeve dhe ankesave, por edhe sigurimit se IPK-ja përformon krahas standardeve ndërkombëtare mbi kontrollin demokratik dhe të pavarur policor.

Viti 2018, ka shënuar edhe një sukses tjetër në drejtim të forcimit të kapaciteteve tona operacionale. Është realizuar Projekti i Këshillit të Evropës “Avancimi i të Drejtave të Njeriut në Policinë e Kosovës”, që është pjesë e “Mekanizmit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, i cili synon të rrisë mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga policia dhe fuqizimin e sistemit të kontrollit të pavarur policor. Ekspertët e këtij Projekti kanë realizuar një vlerësim mbi pavarësinë funksionale dhe operacionale të IPK-së, nevojat për trajnim si dhe kapacitetet. Raportet e publikuara në faqen zyrtare, me analiza dhe vlerësime të Këshillit të Evropës, pasqyrojnë rrugëtimin e sigurt të IPK-së në përmbushje të misionit të përcaktuar me legjislacion.

Në vitin 2019, po hyjmë edhe me një Plan Zhvillimor Strategjik, i cili ka përcaktuar objektiva të qarta mbi rrugën që duhet ndjekur përgjatë tre (3) viteve të ardhshme. Ky dokument është mbështetur nga OSBE-ja.

Këto janë vetëm një pjesë e angazhimeve tona dhe mbetemi të përkushtuar, që edhe në të ardhmen të vazhdojmë në përmbushjen e mandateve, duke konsideruar të nevojshme përkrahjen e vazhdueshme të faktorëve vendor dhe ndërkombëtar. Në fund të kësaj fjale, kërkoj nga qytetarët e vendit tonë, që të bashkëpunojnë me organizatën tonë, drejt zhvillimit të një policie demokratike, të përgjegjshme dhe profesionale, duke i siguruar se shqetësimet e tyre do të trajtohen me kujdesin e duhur. Një falënderim i veçantë shkon edhe për mediat, të cilat kanë përcjellë angazhimet tona, në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të qytetarëve, dhe shtytjes të fuqizimit të rolit tonë mbikëqyrës.

Me respekt!

**Miradije Kelmendi,**  
**Kryeshf Ekzekutiv,**  
**Inspektorati Policor i Kosovës**

## V. HYRJE

---

Ky është raporti përmbledhës i punës së IPK-së për periudhën Janar – Dhjetor 2018 i cili përmban aktivitete dhe të arritura të dokumentuara. Raporti i këtij viti prezanton sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe të arriturat kryesore gjatë kësaj periudhe.

IPK, funksionet e saj i ka zbatuar përmes departamenteve operative që janë: Departamenti për Menaxhimin e Ankesave, Departamenti i Hetimeve, Departamenti i Inspektimeve, Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim, kurse Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme përmes aktiviteteve të saj ka mbështetur funksionimin e departamenteve operative në aspektin administrativ dhe logjistik.

Raporti i këtij viti paraqet edhe sfidat dhe të arriturat kryesore të IPK-së gjatë vitit 2018. Pjesët kryesore të këtij Raporti padyshim janë pjesët ku përmbledhen rezultatet konkrete në pranimin e ankesave dhe të hetimit të rasteve sipas mandateve të IPK-së, bazuar në numrin, kualitetin dhe rezultatet e hetimit të rasteve, si dhe rezultatet konkrete në ushtrimin e funksionit të inspektimit ku paraqiten numri, lloji dhe rezultatet e këtyre inspektimeve.

Mbështetja administrative e cila ofrohet nga Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme na jep të dhëna mbi numrin e trajnimeve dhe nivelin e shpenzimeve buxhetore sipas kategorive ekonomike. Pjesa e bashkëpunimit me qytetarët, organizatat vendore dhe ndërkombëtare përmban aktivitete konkrete të bashkëpunimit të IPK-së me të tjerët duke përfshirë, fushatat e ndryshme të informimit lidhur me të drejtat e qytetarëve, formën dhe mekanizmat e ankimit për të ngritur nivelin e vetëdijesimit sa i përket qasjes në IPK, ngritja e bashkëpunimit me organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare në profesionalizmin dhe në ngritjen e cilësisë së performancës së punonjësve të saj përmes, përmes shkëmbimit të përvojave, trajnimeve, pranimit të këshillimeve dhe mekanizmave tjerë me interes për IPK-në.

## VI. AKTIVITETET E IPK-SË NË MENAXHIMIN E ANKESAVE

Departamenti i Menaxhimi të Ankesave (DMA), përkatësisht Divizioni për Administrimin e Lëndëve (DAL), gjatë vitit 2018 ka pranuar gjithsej 1419 ankesa, ku prej tyre 20 kanë qenë informata, cilat janë pranuar përmes mënyrave të ndryshme në IPK.

<b>Ankesa</b>	1399
<b>Informata</b>	20
<b>Gjithsej raste ( ankesa, informata) të pranuar në DMA</b>	1419

Në tabelat e mëposhtme janë të pasqyruara të dhënat statistikore për numrin e përgjithshëm të ankesave, mënyrat e ushtrimit të ankesave, procedimin e mëtejme të ankesave, numri i ankesave të pranuar sipas gjinisë, sipas nacionaliteteve, ankesat anonime dhe iniciimet e brendshme, numri i ankesave të pranuar sipas muajve dhe në bazë të regjioneve ku punojnë zyrtarët policorë.

<b>Ankesa e pranuar nga qytetarët në zyrat e IPK-së</b>	618
<b>Ankesat e pranuar përmes Policisë së Kosovës</b>	443
<b>Ankesat e pranuar përmes postës elektronike të IPK-së</b>	229
<b>Ankesat e pranuar përmes Departamentit të Hetimeve në IPK</b>	56
<b>Ankesat e pranuar përmes mënyrave tjera në IPK (Prokurori, Gjykata etj)</b>	38
<b>Informatat e pranuar në IPK</b>	20
<b>Ankesat anonime</b>	13
<b>Ankesat e pranuar përmes kutisë së ankesave</b>	02
<b>Gjithsej ankesa të pranuar nga Divizioni i Administrimit të Ankesave</b>	<b>1419</b>

Bazuar në të dhënat e regjistruara në IPK, numri më i madh ankesave nga qytetarët është pranuar në zyrat e IPK-së, ku janë 618 ankesa, pastaj përmes Policisë së Kosovës janë pranuar 443, përmes postës elektronike të IPK-së janë pranuar 229 ankesa, ankesa të pranuar nga Departamentit i Hetimeve në IPK janë 56, përmes institucioneve tjera janë pranuar 38, në formë të informatave janë pranuar 20, ankesa anonime janë pranuar 13 dhe ankesa të pranuar përmes kutive të ankesave janë 2.

Pasi që janë ndërmarr veprimet e nevojshme, hetuesit në kuadër të Divizionit të Administrimit të Lëndëve (DAL), kanë proceduar ankesat tek autoritetet përgjegjëse për t'i hetuar. Duke u bazuar në obligimet ligjore që dalin nga Ligji i IPK-së, DMA ka qenë e hapur dhe transparente me qytetarët, ku varësisht nga hapat që janë ndërmarr për

procedim të mëtejme të ankesës së qytetarit, hetuesit e DAL-it kanë njoftuar parashtruesin e ankesës për statusin e ankesës.

<b>Tabela nr.3: Paraqitja tabelore e procedimit të ankesave nga DMA për trajtim të mëtejme</b>	
<b>Ankesa të proceduara në DSP të PK-së</b>	762
<b>Ankesa te proceduara ne DH të IPK-së</b>	645
<b>Ankesa të proceduara në Institucionet tjera përgjegjëse</b>	8
<b>Ankesa të cilat janë mbyllur në DMA</b>	3
<b>Ankesa te proceduara ne DH të IPK-së- Shkelje disiplinore</b>	1
<b>Gjithsej ankesa të proceduara</b>	<b>1419</b>

Nga numri total prej 1419 ankesave dhe informatave, 762 ankesa janë dërguar në Drejtorinë e Standardeve Profesionale në Policinë e Kosovës (DSP) për hetim disiplinor, 645 ankesa janë proceduar në Departamentin e Hetimeve në IPK, 8 ankesa janë dërguar në institucionet tjera përkatëse, 3 ankesa janë mbyllur në DMA dhe 1 ankesë është proceduar në Departamentin e Hetimeve në IPK për shkelje disiplinore.

Sa i përket klasifikimit të pranimit të ankesave në bazë të gjinisë janë paraqitur këto të dhëna: ankesat e pranuar nga gjinia mashkullore gjatë këtij viti janë: 1032 ankesa ndërsa nga gjinia femërore janë 161 ankesa.

<b>Tabela nr.4: Paraqitja tabelore e ankesave sipas gjinisë së ankuesve</b>	
<b>Ankesat e pranuar nga gjinia mashkullore</b>	1032
<b>Ankesat e pranuar nga gjinia femërore</b>	161
<b>Gjithsej</b>	<b>1193</b>

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën nr.5 e cila jep të dhëna për ankuesit në bazë të nacionalitetit, shihet se shqiptarët kanë bërë numrin më të madh të ankesave -1111 ankesa, pasuar pastaj nga serbët me 65 ankesa, boshnjakët me 9 ankesa, turqit 3 ankesa, romët 1 ankesë, shtetasit e huaj 4 ankesa, inicime të brendshme 193, anonime 13 ankesa dhe në fund 20 informata.

<b>Tabela nr.5: Paraqitja tabelore e ankesave sipas nacionaliteteve</b>	
<b>Ankesat e pranuar nga shqiptarët</b>	1111
<b>Ankesat e pranuar nga serbët</b>	65
<b>Ankesat e pranuar nga turqit</b>	3
<b>Ankesat e pranuar nga boshnjakët</b>	9
<b>Ankesat e pranuar nga romët</b>	1
<b>Ankesat nga shtetasit e huaj</b>	4
<b>Inicimet e brendshme</b>	193
<b>Anonime</b>	13
<b>Informata</b>	20
<b>Gjithsej</b>	<b>1419</b>

Po ashtu, IPK ka bërë edhe një analizë statistikore sipas numrit të pranimit të ankesave përgjatë muajve, ku muajt më të ngarkuar kanë qenë: muaji gusht, nëntor, maj, shtator etj.

<b>Tabela nr.6: Paraqitja tabelore e ankesave të pranuar përgjatë muajve</b>											
<b>Janar</b>	<b>Shkurt</b>	<b>Mars</b>	<b>Prill</b>	<b>Maj</b>	<b>Qershor</b>	<b>Korrik</b>	<b>Gusht</b>	<b>Shtator</b>	<b>Tetor</b>	<b>Nëntor</b>	<b>Dhjetor</b>
97	117	112	113	130	99	116	158	124	112	141	100
<b>Gjithsej</b>						<b>1419</b>					

Gjatë analizimit të ankesave të paraqitura në bazë të drejtorive regjionale ku punojnë zyrtarët policorë rezulton që rajoni i Prishtinës prinë me numrin më të madh të ankesave me 579, Peja me 146 ankesa, regjioni i Ferizajt me 140 ankesa, regjioni i Prizrenit me 115 ankesa, regjioni i Gjilanit me 110 ankesa, regjioni Mitrovicë e Jugut me 74 ankesa, regjioni Mitrovicë e Veriut pason me 57 ankesa dhe regjioni i Gjakovës me 69 ankesa. Kurse, sa i përket numrit të ankesave ndaj zyrtarëve policor që punojnë në Policinë kufitare është një numër dukshëm më i vogël, vetëm 33 ankesa të cilat në detaje janë të paraqitura në mënyrë tabelore më poshtë. Vlen të theksohet se kemi një numër të konsiderueshëm të ankesave ku nuk dihet se ku punon zyrtari policor i dyshuar dhe numri i tyre është 96.

**Tabela 7. Paraqitja tabelore e ankesave sipas Drejtorive Rajonale**


Muajt 2018	Tot. Ank	Prishtinë	Pejë	Gjilan	Ferizaj	Prizren	Mitro Jug.	Mitr. Ver.	Gjakovë	Jarinjë	Kullë	.Merdar	Luzhan	Kaçanik	Gjakovë	Vërmicë	N.N
<b>Janar</b>	97	37	5	13	12	10	5	2	4	0	0	0	0	1	0	0	8
<b>Shkurt</b>	117	54	12	12	12	10	6	3	2	0	0	0	0	0	0	0	6
<b>Mars</b>	112	39	13	12	13	12	7	3	3	0	0	2	0	1	1	0	6
<b>Prill</b>	113	41	11	8	15	6	8	6	6	0	0	1	2	0	1	0	8
<b>Maj</b>	130	49	13	12	8	10	11	6	6	0	0	0	1	3	0	1	10
<b>Qersh.</b>	99	42	7	8	11	5	5	3	9	0	0	0	0	1	0	0	8
<b>Korrik</b>	116	55	9	4	10	11	4	4	6	0	0	0	0	2	0	0	11
<b>Gusht</b>	158	69	15	7	18	17	8	5	8	0	0	0	0	1	0	0	10
<b>Shtat.</b>	124	38	18	10	10	12	4	10	6	0	0	2	4	0	0	1	9
<b>Tetor</b>	112	46	21	9	8	6	5	4	5	0	0	0	1	2	0	1	4
<b>Nëntor</b>	141	63	11	9	15	10	6	8	7	0	0	0	0	3	0	0	9
<b>Dhjetor</b>	100	46	11	6	8	6	5	3	7	0	0	1	0	0	0	0	7
<b>Gjithsej</b>	<b>1419</b>	<b>579</b>	<b>146</b>	<b>110</b>	<b>140</b>	<b>115</b>	<b>74</b>	<b>57</b>	<b>69</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>14</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>96</b>

## VII. AKTIVITETET E IPK-SË NË HETIMET E RASTEVE

Në përputhje me misionin e IPK dhe referuar fushë veprimtarisë, Departamenti i Hetimeve gjithnjë aktivitetet dhe angazhimet e tij i ka të ndërlidhura nga organizimi i brendshëm i Policisë së Kosovës (PK) dhe bazuar në këtë, Raporti është refleksion i dinamikës organizative të Policisë së Kosovës.

Andaj, gjatë periudhës së raportimit (2018), Policia e Kosovës ka pasur 8634<sup>1</sup> punonjës, prej të cilëve në përgjithësi si subjekt i hetimit nga IPK-ja kanë qenë 198 punonjës të PK-së (theks i veçantë është se numri i punonjësve sipas identitetit është 194 punonjës policor)<sup>2</sup>. E shprehur në përqindje i bie që vetëm 2.29 % i punonjësve të PK-së janë hetuar nga IPK-ja me dyshimin se kanë kryer vepra penale apo 0.09% më shumë se vitin e kaluar. Pra, në vitin 2018 numri i punonjësve të hetuar është më i madh për 8 punonjës krahasuar me vitin 2017.


***Tabela 8: Numri i Punonjësve të hetuar nga IPK-ja (2016-2018)***



<sup>1</sup> Të dhënat zyrtare nga Policia e Kosovës të pranuar përmes postës elektronike(e-mail) më 31.12.2018, .

<sup>2</sup> Në këtë situatë një punonjës policor me gradën e Nënkolonelit është regjistruar në pesë raste, andaj kemi rritje të numrit gjithsej në 198 .



**Diagrami nr. 1 Pasqyra e rasteve penale**



Departamenti i Hetimeve përgjatë vitit 2018, përmes Divizionit për Menaxhimin e Ankesave ka pranuar gjithsej 646 raste. Prej numrit të përgjithshëm të pranuar në DH, pas veprimeve të ndërmarra hetimore gjendja rezulton si në vijim:

- a) 329 raste janë dërguar në DSP për hetim të mëtejshëm disiplinor;
- b) 143 raste kanë marrë numër penal;
- c) 174 raste që janë në proces të hetimit preliminar.

**Diagrami nr. 2 Statusi i rasteve dhe mënyra e dërgimit të rasteve në Prokurori**






Gjatë vitit 2018, Departamenti i Hetimeve në prokuroritë kompetente ka dërguar gjithsej 108<sup>3</sup> raste, të cilat në mënyrë më të detajuar janë si më poshtë:

- a) 90<sup>4</sup> raste me kallëzim penal,
- b) 18<sup>5</sup> raste me raport të veçantë.

Ndërsa të gjitha rastet tjera të cilat numerikisht janë 35<sup>6</sup> janë bartur për vitin e ardhshëm (2019) për hetim të mëtejshëm.

**Diagrami nr. 3 Statusi i rasteve në Prokuroritë kompetente**



Gjatë vitit 2018, prej 108 rasteve të dërguara në prokuroritë kompetente janë ngritur 41 aktakuza, janë hedhur poshtë 15 kallëzime penale, kurse në proces për hetime të mëtejshme janë 52 raste.

Departamenti i Hetimeve gjatë proceseve hetimore ka ardhur në situata kur ka arrestuar personat nën dyshime të arsyeshme që kanë kryer vepra penale duke vënë në zbatim dispozitat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, si dhe ka rekomanduar masa administrative për suspendimin dhe transferimin e zyrtarëve

<sup>3</sup> Rastet e përgjithshme të cilat janë dërguar në Prokurorinë e Shtetit.

<sup>4</sup> Bazuar në të dhënat dhe provat e mbledhura, Policia (në rastin e Inspektoratit hetuesit e IPK-së) përpilon kallëzim penal të policisë në të cilin paraqiten provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave, (bazuar në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, neni 81, paragrafi 1).

<sup>5</sup> Nëse nga masat dhe veprimet e kryera nga policia, provat dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë bazë për kallëzim penal të policisë dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer vepra penale, policia megjithatë i dërgon për këtë raport të veçantë prokurorit të shtetit (bazuar në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, neni 8, paragrafi 4).

<sup>6</sup> Raste që janë bartur në vitin 2019 e të cilat janë regjistruar me numër penal.

policor duke vënë në zbatim dispozitat e parapara në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës<sup>7</sup>.


**Diagrami 4 Pasqyra e personave të arrestuar, suspenduar dhe transferuar**



Kështu bazuar të dhënave nga Departamenti i Hetimeve, që kanë ndërmarrë veprimet e kërkuara ligjore, gjendja për vitin 2018 është si në vijim:

- a) 12 arrestime;
- b) 50 suspendime;
- c) 10 transfere.


<sup>7</sup> Kur IPK konsideron se është në interes të hetimeve, i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë formën e veprimit që mund përfshijë por nuk kufizohet në llojet e suspendimit me pagesë apo transferimin. Rekomandimi duhet të shoqërohet me një deklaratë, e cila përmban arsyet e rekomandimit. (Ligji nr. 03/L-231 neni 17 pika 12).



Gjatë vitit 2018, IPK-ja ka hetuar raste në drejtim të veprave të ndryshme penale, ndërkaq veprat penale më të shpeshta që u hetuan gjatë vitit 2018 ishin:

- 46 raste “rrezikim i trafikut publik”;
- 27 raste “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”;
- 23 raste “lëndim i lehtë trupor”;
- 19 raste “keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”;
- 05 raste “manipulimi me prova”.


*Diagrami nr. 5 Pesë veprat më të shpeshta (2016, 2017 dhe 2018)*



Gjatë viteve të kaluara (2016-2018) pothuajse të njëjtat vepra penale prijnë në listën e pesë veprave më të shpeshta në kompetencë të Departamentit të Hetimeve për t'u hetuar.

Vlen të theksohet që ka trend të rënies së veprave penale “rrezikim i trafikut publik” dhe “keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar”. Ndërsa shqetësuese mbetet ngritja e numrit të rasteve për veprën penale “keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare”, “lëndim i lehtë trupor” dhe “manipulimit me prova”.

**Diagrami nr. 6 Veprat penale me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare ( 2016, 2017 dhe 2018)**




Departamenti i Hetimeve edhe gjatë vitit 2018, ka qenë i përkushtuar që me gjithë potencialin e tij të vë theksin e veçantë në luftën kundër korrupsionit. Andaj si rezultat i angazhimit ka hetuar 36 raste me vepra penale kundër detyrës zyrtare ndër të cilat më të shpeshtat kanë qenë: 27 raste të “keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar”, 4 raste të “falsifikimit të dokumentit zyrtar”, 1 rast të “marrjes së ryshfetit”, 1 rast të “ushtrimit të ndikimit”, 3 raste “zbulimi i fshehtësisë zyrtare”. Ndërsa sa i përket veprave si: “dhënia e ryshfetit”, “përvetësimi në detyrë”, dhe “konflikti i interesit”, janë vepra që nuk janë shfaqur gjatë kësaj periudhe të raportimit.

## - Gradat dhe njësitë strukturore të 198 punonjësve të PK-së të hetuar nga IPK-ja

Duke pasur parasysh që Policia e Kosovës ka një strukturë organizative me funksione dhe detyra të ndryshme, atëherë kjo organizatë udhëhiqet nga punonjësit policor të cilët janë të graduar në përputhje me funksionet të cilat i ushtrojnë. Kështu, nga numri i përgjithshëm punonjësve të PK-së (8634 punonjës), 7589 janë zyrtarë policorë me grada të ndryshme, ndërsa personel civil - pa kompetenca policore janë 1045.


**Diagrami nr. 7 Numri i punonjësve të PK-së sipas strukturës organizative dhe numri i të hetuarve nga IPK-ja në tërë Policinë e Kosovës sipas gradave**



Për shpjegime të mëtejme, në Policinë e Kosovës të graduar janë 1735 zyrtarë policorë, të cilët menaxhojnë të gjitha vijat e menaxhimit, nga vija e parë menaxhuese e deri te niveli i lartë drejtues ekzekutiv, të cilët në mënyrë specifike përbëhen nga 1143 rreshterë, 303 togerë, 161 kapitenë, 60 majorë, 62 nënkolonelë, 15 kolonelë, 5851 policë, 3 policë të rinj dhe 1045 staf civil.<sup>8</sup>

<sup>8</sup> Të dhënat e marra përmes postës elektronike(e-mail) të datës 31.12.2018, nga Drejtoria e Personelit PK-së.


*Diagrami nr. 8 Gradat e punonjësve të PK-së të hetuar nga IPK (2016, 2017 dhe 2018)*



Në kuadër të kësaj Departamenti i Hetimeve paraqet krahasimin në mes të numrit total të punonjësve sipas gradave të PK-së dhe numrit të hetuarve nga Departamenti i Hetimeve për vepra penale të këtyre punonjësve të Policisë së Kosovës. Andaj, gjatë vitit 2018, Departamenti i Hetimeve ka hetuar 20 zyrtarë policor të graduar, prej tyre 1 nënkolonel, 1 major, 4 kapitenë, 2 togjerë, 12 rreshterë, 150 polic dhe 24 punonjës nga stafi civil, të cilët në numrin e përgjithshëm janë 194 punonjës.

Bazuar në strukturën e saj organizative, Policia e Kosovës përbëhet nga pesë departamente ku numrin më të madh të personelit e ka Departamenti për Operacione për shkak se ky departament ka në varësi të tij hierarkike 8 drejtoritë rajonale policore e në të cilat janë të përfshira 41 stacionet policore të shpërndara në tërë vendin. Kështu departamenti për Operacione përfshin 6105 punonjës apo 70.7% të tërë personelit të Policisë së Kosovës, Departamenti i Kufirit 1313 punonjës apo 15.2 %, Departamenti për Hetime 615 apo 7.12 %, Departamenti për Shërbime Mbështetëse 265 punonjës apo 3.1%, dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore 132 punonjës ose 1.5 % e personelit në Policinë e Kosovës.


***Diagrami nr. 9 Paraqitja tabelore e shpërndarjes së 194 punonjësve të PK-së të hetuar nga IPK-ja sipas Departamenteve në Policinë e Kosovës***



Sipas të dhënave të regjistruara dhe referuar strukturës organizative të PK-së, nga e cila rrjedh lista e personelit të saj, numri më i madh i të hetuarve nga Departamenti i Hetimeve janë punonjës të Departamentit për Operacione, ku nga 6105 punonjës që ka ky departament, subjekt i hetimeve kanë qenë gjithsej 142 punonjës. Departamenti për Kufi nga 1313 punonjës, të hetuar ka 22 punonjës. Departamenti për Hetime prej 615 punonjësve, të hetuar ka pasur 10 punonjës, Departamenti për Shërbime Mbeshtetëse nga 265 punonjës, të hetuar ka pasur 20 punonjës dhe Departamenti për Burime Njerëzore nga 131 punonjës nuk kishte të hetuar asnjë (0) punonjës të saj.

Departamenti për Operacione ndahet në tre (3) divizione dhe atë në Divizionin për Siguri Publike, Divizionin e Njësive të Specializuara dhe Divizionin e Komunikacionit Rrugor, prej të cilëve Divizioni për Siguri Publike përfshinë numrin më të madh të punonjësve policor.

Diagrami nr. 10 Shpërndarja e 142 punonjësve të hetuar nga IPK-ja në Departamentin për Operacione sipas nënndarjeve të saj në divizione



Pasi që Divizioni për Siguri Publike ka numrin më të madh të punonjësve, edhe numri i të hetuarve nga ky Divizion është më i madh se në Divizionet e tjera - 120 punonjës.


Bazuar në krahasimet e të dhënave sipas viteve shihet se në Divizionin për Siguri Publike dhe Divizionin e Komunikacionit Rrugor ka ngritje të punonjësve të hetuar kurse në Divizionin e Njësive të Specializuara ka rënie të hetimit për punonjësit e tyre.

Policia e Kosovës në përshkallëzimin e saj strukturor nga Divizioni i Sigurisë Publike bie në nivel të Drejtorive Rajonale Policore të cilat në numrin e përgjithshëm janë 8 dhe përfshijnë DRP- Prishtinë, DRP-Mitrovicë Veriu, DRP-Prizren, DRP- Ferizaj, DRP-Mitrovicë Jugu, DRP-Gjilan, DRP-Pejë dhe DRP-Gjakovë.

Të dhënat e IPK-së nga Departamenti i Hetimeve tregojnë se në DRP- Prishtinë janë hetuar 23 punonjës policor, DRP-Mitrovicë Veriu janë hetuar 14 punonjës policor, DRP-Prizren 13 punonjës policor pasuar nga Drejtoritë e tjera (shih diagramin nr 11 si më poshtë).




Diagrami nr. 11 Paraqitja tabelore e shpërndarjes së 120 punonjësve të hetuar nga IPK-ja sipas Drejtorive Rajonale Policore



Në kuadër të kësaj Departamenti i Hetimeve paraqet krahasimin në mes të numrit total të punonjësve sipas drejtorive rajonale policore dhe numrit të hetuarve për vepra penale të këtyre punonjësve të Policisë së Kosovës. Andaj, gjatë vitit 2018, rritje të numrit të punonjësve të hetuar ka pasur DRP- Prishtinë, DRP-Mitrovicë Veriu, DRP-Ferizaj dhe DRP-Gjakovë. Ndërsa, ulje në hetimin e punonjësve policor ka pasur DRP-Prizren, DRP-Mitrovicë Jugu, DRP-Gjilan dhe DRP-Pejë.

Përshkallëzimi tjetër strukturor në Drejtoritë Rajonale Policore bie në nivelin e Stacioneve Policore, të cilat në numrin e përgjithshëm janë 41 stacione policore të shpërndara në tërë vendin.

*Diagrami nr. 12 Punonjësit e PK-së të hetuar nga IPK-ja sipas Stacioneve Policore*




Sipas numrit të përgjithshëm të 41 stacioneve policore, dhe referuar të dhënave vërehet se Stacioni Policor Ferizaj ka pasur numrin më të madh të punonjësve të hetuar nga Departamenti i Hetimeve, në gjithsej 24 punonjës duke u pasuar nga Gjilani dhe Stacioni Policor Jugu Prishtina me nga gjithsej 9 punonjës, Stacioni Policor Mitrovicë Veriu me 7 punonjës etj.

Vlen të ceket se 11 stacionet policore nuk kanë pasur të përfshirë në hetime asnjë punonjës policor.

Po ashtu edhe Policia e Kufitare në organizmin e saj strukturor është e përshkallëzuar edhe në nivelin e Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare, të cilat janë të ndarë në nivele dhe më konkretisht në DRPK -Veri, DRPK -Lindje, DRPK -Perëndimi dhe Aeroporti i Prishtinës.


**Diagrami nr. 13 : Punonjësit e PK-së të hetuar nga IPK-ja sipas Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare**



Nga të dhënat e paraqitura shihet se DRPK Perëndimi kryeson me 8 punonjës policor të hetuar i pasuar nga DRPK Veriu dhe DRPK Lindje me nga 5 punonjës të hetuar dhe Stacioni Policor i Aeroportit të Prishtinës me 4 punonjës të hetuar.

Përshkallëzimi tjetër strukturor në DRPK bie në nivelin e SPK, SPMK dhe Pikat e Kalimit Kufitar të cilat në numrin e përgjithshëm janë 27 sosh të shpërndara në tërë vendin.

**Diagrami nr. 14 Punonjësit e PK-së të hetuar nga IPK-ja sipas Stacioneve Policore Kufitare**



Nga të dhënat e paraqitura shihet se Stacioni Policor Aeroporti Prishtinë kryeson me 4 punonjës policor të hetuar i pasuar nga SPMK-Vitomiricë, SPK-Hani Elezit dhe SPK-Qafa Prushit me 2 punonjës policor të hetuar, SPMK- Leposaviq, SPK-Jarinje, SPMK-Zubin Potok, SPMK-Keqekollë dhe SPK-Vërmicë me 1 punonjës policor të hetuar.

Ndërsa të gjitha SPK-të tjera, SPMK-të dhe Pikat e Kalimit Kufitar nuk kanë pasur të përfshirë në hetime asnjë punonjës policor.

Duke pasur parasysh që Departamenti i Hetimeve si objekt të saj të veprimit ka edhe hetimin e shkeljeve e disiplinore të profilit të lartë<sup>9</sup> dhe shkeljet disiplinore të zyrtarëve policor me gradën më të larë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv, gjatë punës së tij është ballafaquar edhe me raste të tilla.

<b>Tabela nr. 9: SHKELJET DISIPLINORE</b>	<b>Numri i rasteve</b>
<b>Shkeljet disiplinore të nivelit të lartë menaxhues dhe ekzekutiv</b>	1
<b>Shkeljet disiplinore të profilit të lartë</b>	4

Kështu që gjatë vitit 2018, Departamenti i Hetimeve ka regjistruar gjithsej pesë (5) raste me karakter disiplinor të cilat janë si në vijim:

- a) 4 raste shkelje disiplinore të zyrtarëve me gradën të nivelit të lartë menaxhues dhe ekzekutiv<sup>10</sup>,
- b) 1 rast shkelje të profilit të lartë disiplinor.

<sup>9</sup> Incident disiplinor i profilit të lartë - incidenti ose trendi i ngjarjeve që tërheqin vëmendje domethënëse të publikut duke përfshirë, por pa u kufizuar në supozimet si: konflikte apo incidente të drejtpërdrejta në mes policisë dhe komuniteteve që ndërlidhet me veprimet racore, etnike apo diskriminuese, një problem akut i konfliktit të drejtpërdrejtë në mes policisë dhe komuniteteve. Konflikti mund të jetë në formën e ngacimit, brutalitetit apo përdorimit të forcës së tepruar nga ana e Policisë, të gjitha incidentet e përdorimit të forcës vdekjeprurëse, të gjitha vdekjet gjatë mbajtjes nën kontroll nga policia, aksidentet fatale të trafikut ku përfshihen punonjësit e policisë.

<sup>10</sup> hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv.

## VIII. INSPEKTIMET GJATË VITIT 2018

---

Një ndër funksionet bazë të IPK-së është edhe zhvillimi i inspektimeve ndaj Policisë së Kosovës. Përmes procesit të inspektimit, IPK-ja bën vlerësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave duke:


- Përcaktuar nëse ligjet, rregulloret përkatëse dhe parimet e procedurat e PK-së, zbatohen ashtu si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saj;
- Përcaktuar nëse burimet e Policisë, shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe efikase si dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat organizative;
- Parandaluar shkeljet që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së PK-së;
- Identifikuar mangësitë, dobësitë dhe duke rekomanduar masa ligjore dhe organizative për funksionim më të mirë të PK-së.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2018, Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi në kuadër të Departamentit të Inspektimit ka nxjerrë Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, i cili është miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së. Nxjerrja e këtij Plani ka kaluar në disa faza, duke marrë parasysh shumë faktorë dhe rrethana. Plani ka vënë para vetes disa objektiva të inspektimit, që kanë rezultuar nga objektivat strategjike të organizatës dhe Programit të Qeverisë.

Në përmbushje të përgjegjësiave dhe detyrave, Divizioni i Inspektimit dhe Raportimit në kuadër të Departamentit të Inspektimit në drejtim të vlerësimit të kryerjes së detyrave policore në raport me legjislacionin dhe standardet e kërkuara, gjatë vitit 2018 ka realizuar nëntë (9) inspektime, nga të cilat, pesë (5) të rregullta bazuar në Planin Vjetor të Inspektimit dhe katër (4) të jashtëzakonshme. Gjatë vitit 2018 janë realizuar këto inspektime:

1. Respektimi i procedurave dhe rregullave nga Policia e Kosovës gjatë largimit me forcë të shtetasve turq nga territori i Republikës së Kosovës (inspektim i jashtëzakonshëm);
2. Respektimi i procedurave dhe rregullave gjatë trajtimit të incidentit me përfshirje të zyrtarëve policorë (inspektim i jashtëzakonshëm);
3. Menaxhimi i armëve të zjarrit, municionit dhe pajisjeve policore (inspektim i rregullt);
4. Menaxhimi i burimeve njerëzore të Policisë së Kosovës (inspektim i rregullt);
5. Respektimi i rregullave dhe procedurës së trajtimit të dëshmive në Drejtorinë Rajonale në Mitrovicë-Veriu dhe Stacionin Policor në Shtime (inspektim i jashtëzakonshëm);
6. Kryerja e detyrave gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje (i jashtëzakonshëm);

7. Menaxhimi i procedurave të shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit (inspektim i rregullt);
8. Menaxhimi i planeve vendore të policimit, të sigurisë në komunitet dhe nismave të policimit në komunitet (inspektim i rregullt);
9. Menaxhimi i ankesave dhe hetimit disiplinor (inspektim i rregullt).



## **PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E INSPEKTIMEVE TË REALIZUARA GJATË VITIT 2018**

### **Inspektimi nr. 01/2018: Respektimi i procedurave dhe rregullave nga Policia e Kosovës gjatë largimit me forcë të shtetasve turq nga territori i Republikës së Kosovës**

Më 29 mars 2018, nga territori i vendit tonë janë larguar me forcë një numër shtetasish turq, pas revokimit të leje qëndrimeve nga organet kompetente. Në procesin e largimit të tyre janë përfshirë disa akterë institucional dhe kjo ngjarje ka bërë bujë të madhe në opinionin vendor e ndërkombëtar.

Për të vlerësuar menaxhimin e kësaj situatë nga Policia e Kosovës si një nga akterët e përfshirë në proces, IPK ka filluar një inspektim të jashtëzakonshëm për të vlerësuar respektimin e rregullave dhe procedurave nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Departamentit të Kufirit.

Ky inspektim ka rezultuar me gjithsej dhjetë (10) rekomandime dhe Raporti i inspektimit iu ka adresuar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, por nuk është publikuar për shkak të përmbajtjes së ndjeshme të tij.

### **Inspektimi nr. 02/2018: Respektimi i procedurave dhe rregullave gjatë trajtimit të incidentit me përfshirje të zyrtarëve policorë (30 dhjetor 2017)**

Më 30 dhjetor 2017, në rrugën 'Enver Zymberi' në Prishtinë, në afërsi të Ambasadës së Kroacisë, ka ndodhur një incident, i pasuar me përleshje fizike, dhe në të cilin janë përfshirë dy (2) qytetarë dhe dy (2) zyrtarë policorë. Rasti fillimisht është trajtuar nga hetuesit e Departamentit të Hetimeve, por në ndërkohë bazuar në shqetësimet e Ministrit të Punëve të Brendshme mbi rastin, krahas hetimeve është realizuar edhe një inspektim i jashtëzakonshëm për të vlerësuar respektimin e procedurave dhe rregullave nga Policia e Kosovës në trajtimin e incidentit në fjalë.

Ky inspektim ka rezultuar me një (1) Rekomandim dhe Raporti i inspektimit iu ka adresuar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, por nuk është publikuar për shkak të statusit të rastit në procedurë penale.



## **Inspektimi nr. 03/2018: Menaxhimi i armëve të zjarrit, municionit dhe pajisjeve policore**

*Inspektimi është realizuar bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta për vitin 2018. Inspektimi ka mbuluar periudhën vjetore 2016-2017 dhe në gjendjen aktuale lidhur me menaxhimin e armëve të zjarrit, municionit dhe pajisjeve tjera policore. Inspektimi është përqendruar në Drejtorinë e Logjistikës, Njësinë për Armë dhe Municion, Divizionin e Njësive të Specializuara, Drejtoritë Rajonale Policore dhe Drejtoritë Rajonale Policore Kufitare.*

Armët, municionet dhe pajisjet e disponueshme nga Policia e Kosovës janë nga kategoritë e Listës së Pajisjeve për Qëllime të Veçanta të parapara me ligjin në fuqi. Lidhur me armët, municionin dhe pajisjet mbahen evidenca nga Njësia e Armëve e Municionit, kurse baza e të dhënave ka nevojë të gjenerojë informata më përmbajtësore apo më të zgjeruara. Me gjithë buxhetin e ndarë për furnizim me armë, municion dhe pajisje policore, mbetet jo i kënaqshëm trendi aktual i realizimit të projekteve dhe nevojitet mobilizim drejt ngritjes së këtyre kapaciteteve. Afërsisht rreth 2% e rasteve të raportuara të përdorimit të forcës nga zyrtarët policorë janë me natyrë të përdorimit të armëve të zjarrit, apo të përfshirjes së tyre në të shtëna me armë zjarri. Edhe më i ulët mbetet numri i rasteve të cilat pas hetimit të ndërmarrë nga autoritetet kompetente kanë rezultuar me dyshim për përdorim të pavend të armës zyrtare. Duhet të organizohen inspektime më të shpeshta në hapësirat ku ruhen apo mbahen armët, municioni dhe pajisjet, përfshirë Depon kryesore dhe armëtoret, si dhe lidhur me aktivitetet e tilla të nxjerrjen raporte si dëshmi mbi inspektimet. Ka avancim në sigurimin e armëve e municionit në ambiente dhe dollapë të sigurtë, në raste kur zyrtarët policorë të ngarkuar me to, nuk gjenden përkohësisht në punë. Lidhur me poligonet e qitjes që shërbejnë për verifikimin e shkathtësive të personelit të uniformuar në përdorimin e armëve të zjarrit, nuk është përmbyllur procesi i bartjes së pronësisë dhe në shumicën prej tyre, Policia e Kosovës del të jetë shfrytëzues i pronave të tilla. Lidhur me kushtet e ruajtjes dhe sigurisë së armëve, municionit e pajisjeve vërehet avancim në mënyrën e akomodimit dhe ruajtjes së tyre. Depoja kryesore e armëve, municionit dhe pajisjeve ka përmirësuar gjendjen sa i përket kushteve teknike e të sigurisë. Ky inspektim ka rezultuar me 14 rekomandime dhe Raporti i inspektimit iu ka adresuar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, por nuk është publikuar për shkak të përmbajtjes së ndjeshme të tij.

## **Inspektimi nr. 04/2018: Menaxhimi i burimeve njerëzore në Policinë e Kosovës**

Inspektimi është realizuar bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta për vitin 2018 dhe ka mbuluar vitet 2016-2017, si dhe gjendjen aktuale të menaxhimit të burimeve njerëzore të Policisë së Kosovës. Inspektimi është përqendruar në departamente, divizione, drejtori, drejtori rajonale policore dhe drejtori rajonale policore kufitare.



Policia e Kosovës vazhdon të ballafaqohet me mungesa dhe tejkallim të numrit të punonjësve në disa departamente. Inspektimi ka vënë në pah nevojën e shpërndarjes më adekuate të personelit të graduar, meqë janë konstatuar tejkallime dhe mungesa të të graduarve në pozitat brenda strukturave të departamenteve. Nevojitet shtimi i personelit me të gjitha gradat, pasi është konstatuar mungesë e 130 gradave. Janë identifikuar disa njësi ende të pafunksionalizuara të parapara me Rregullore. Në rastet e ushtruesve të detyrave, ka shënuar ngritje numri i rasteve kur janë tejkalluar afatet për ushtrimin e detyrës. Lidhur me konkurset e brendshme janë evidentuar disa raste kur nuk është respektuar rregulli për përbërjen e paneleve. Në disa raste që lidhen me promovimin e zyrtarëve nga komuniteti pakicë, nuk janë respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat mbi marrëdhënien e punës. Sipas mostrës së siguruar të formularëve të vlerësimit të performancës në punë, vërehen lëvizje pozitive drejt përmbushjes së obligimeve lidhur me këtë fushë. Treguesit e performancës tregojnë se janë shtuar fushat e trajnimeve, numri i trajnimeve dhe i pjesëmarrësve për trajnimet e organizuara nga Divizioni i Trajnimeve në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Trajnimet jashtë vendit janë dyfishuar dhe janë zhvilluar në shumë vende të botës. Numri i seminareve, konferencave, takimeve dhe vizitave jashtë vendit janë përgjysmuar si në numër, po ashtu edhe në pjesëmarrje.

Është evident shtimi i rasteve me sëmundje të veçanta dhe me këtë është ngritur edhe numri i privilegjeve shëndetësore. Është evident kontributi i Policisë në senzibilizimin mbi përkujdesin shëndetësor dhe psikologjik. Pushimet mjekësore qoftë në kohëzgjatje nga një (1) deri në tre (3) ditë, por edhe ato mbi tre (3) ditë kanë shënuar ngritje të lehtë.

Policia ka funksionalizuar një pjesë të Sistemit të ashtuquajtur 'PRIMS', përmes

të cilit menaxhohen informata mbi burimet njerëzore policore në formë elektronike. Në praktikë janë evidentuar vështirësi në mënyrën e funksionimit të tij. Është duke u punuar në vazhdimësi për kompletimin e sistemit të arkivimit elektronik, duke i kushtuar rëndësi edhe sigurimit të kushteve fizike dhe të sigurisë. Ky inspektim ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime dhe Raporti i inspektimit iu ka adresuar Ministrin të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, si dhe është publikuar në faqen zyrtare.

### **Inspektimi nr. 05/2018: Respektimi i rregullave dhe procedurave të trajtimit të dëshmive në Drejtorinë Rajonale Policore të Mitrovicës “Veriu” dhe Stacionin Policor të Shtimes**



*Inspektimi ka mbuluar periudhën vjetore 2016-2017 dhe gjendjen aktuale të menaxhimit të dhomave të dëshmive. Inspektimi është përqendruar në Drejtorinë Rajonale Policore të Mitrovicës “Veriu” dhe Stacionin Policor të Shtimes. Inspektimi është autorizuar nga Kryeshefi Ekzekutiv pas kërkesave të Departamentit të Hetimeve për nevojën e realizimit të një inspektimi të jashtëzakonshëm lidhur me menaxhimin e dhomave të dëshmive në këto struktura policore.*

*Inspektimi vë në pah nevojën e sigurimit të hapësirave më të përshtatshme për punë dhe akomodim të dëshmive, konsolidimin e evidencave mbi dëshmitë, përmirësimin e kushteve brenda dhomave të dëshmive, trajtimin më të duhur të dëshmive dhe kryerjen e të gjitha formave të kontrollit të tyre.*

Ky inspektim ka rezultuar me gjithsej 12 rekomandime dhe Raporti i inspektimit iu ka adresuar Ministrin të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, por nuk është publikuar për shkak të përmbajtjes së ndjeshme të tij.

## **Inspektimi nr. 6/2018: Kryerja e detyrave gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje**

Inspektimi është autorizuar nga Kryeshefi Ekzekutiv pas kërkesës së Ministrit të Punëve të Brendshme, i cili ka shprehur brengën e tij për trendin shqetësues të rasteve të dhunës në familje. Inspektimi është realizuar në të gjitha drejtoritë



rajonale policore dhe në nga një stacion policor në kuadër të tyre. Inspektimi ka patur për fokus aktivitetet e sektorëve rajonal të hetimeve dhe atyre të stacioneve. Inspektimi ka mbuluar vitet 2016-2017 dhe gjendjen aktuale. Inspektorët kanë kontrolluar 24 dosje të trajtuara nga Policia lidhur me dhunën në familje. Shumica nga to janë cilësuar si: lëndim i lehtë trupor, lëndim i rëndë trupor, kanosje, sulm, ngacmim, vepra penale, të cilat në Kodin Penal të Kosovës janë përcaktuar si vepra që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

Qeveria ka hartuar një Strategji Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në frymën e konventave që adresojnë parandalimin dhe luftimin e formave të diskriminimit, përfshirë edhe dhunën në familje. Policia e Kosovës në kuadër të përgjegjësisë, problematikën e dhunës në familje e trajton brenda kornizave të ligjeve bazike. Statistikat tregojnë se në nivel të përgjithshëm të Policisë, viteve të fundit janë shtuar rastet e dhunës në familje, kurse vetëm në vitin 2017 janë shtuar rastet për 10.6%. Drejtoria Rajonale Policore - Prishtinë mbetet më e prekura dhe ka numrin më të madh të rasteve të raportuara të dhunës në familje, derisa me numër më të ulët të tyre dallohet Drejtoria Rajonale Policore në Mitrovicë - Veriu. Ngritjen më të madhe të numrit të rasteve në vitin 2017 krahasuar me vitin paraprak e ka shënuar Prizreni dhe Prishtina, derisa Mitrovicë - Veriu ka shënuar rënien më të madhe krahasuar me një vit më parë. Kurse, numri i të arrestuarve mbetet pothuajse i nivelit të njejtë për dy vitet. Për vitin 2016, shkalla e realizimit të rasteve të dhunës në familje ka arritur kuotën 93.8%, derisa në vitin 2017 në 95.1%. Drejtoria Rajonale Policore në Mitrovicë - Jugë ka një ngecie që pasqyrohet përmes kuotave që shënojnë rënie. Ky inspektim ka rezultuar me katër (4) rekomandime dhe Raporti i inspektimit iu ka adresuar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, si dhe është publikuar në faqen zyrtare.

## **Inspektimi nr. 7/2018: Menaxhimi i procedurave të shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit**

*Inspektimi është realizuar bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta për vitin 2018 dhe është fokusuar në të gjitha Qendrat e Ndalimit në kuadër të stacioneve policore. Janë kontrolluar 357 dosje të të ndaluarve dhe janë inspektuar kushtet fizike dhe të sigurisë brenda 20 Qendrave të Ndalimit, me gjithsej 85 dhoma ndalimi.*



Gjatë verifikimit mbi përdorimin e formave standarde të Qendrave të Ndalimit, Inspektimi ka vënë në pah se një numër dosjesh të mostruara nuk kanë aplikuar standardet e përcaktuara me shtojcat e Procedurës Standarde të Operimit dhe rastet e tilla janë identifikuar në 11 Qendra të Ndalimit. Një

numër i ulët i dosjeve të të ndaluarve nuk i kanë pasur të bashkëngjitura të drejtat e të ndaluarve. Diku në rreth  $\frac{1}{4}$  e dosjeve të kontrolluara janë identifikuar formularë me të drejtat e personave të ndaluar që nuk janë të harmonizuar me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Janë evidentuar mangësi në plotësimin e formularëve nga zyrtarët policor të Qendrave të Ndalimit. Në formularët e të dhënave mbi pronën personale të të ndaluarve, në disa raste vërehen mangësi të dhënash mbi pranimin-dorëzimin e sendeve, specifikat e tyre, llojin, sasinë, etj. Në një numër të ulët të dosjeve nuk ka pasur Aktvendim mbi ndalimin. Gjatë një ankete të zhvilluar me të ndaluarit, inspektorët janë siguruar se ndaj tyre respektohet e drejta për kohën e pushimit dhe marrjen e ushqimit. Lidhur me të drejtën për shërbim mjekësor, në disa dosje të të ndaluarve nuk është gjetur formulari që shpalosë gjendjen mjekësore dhe ofrimin e shërbimit mjekësor për të ndaluarit. Ky inspektim ka pasqyruar se Qendrat e Ndalimit kanë respektuar standardin mbi kontrollin e të ndaluarve nga personat e gjinisë së njejtë. Nga kontrolli i dosjeve të të ndaluarve ka rezultuar se në të gjitha rastet është respektuar standardi mbi lirimin e të ndaluarit, konform afateve ligjore prej 48 orësh, respektivisht 24 orësh. Inspektimi shtron nevojën e përmirësimit të kushteve fizike dhe të sigurisë në Qendrat e Ndalimit.

Gjatë inspektimit është vlerësuar veç tjerash edhe përmbushja e rekomandimeve nga inspektimet e kaluara. Nga inspektimi i kryer në këtë fushë të menaxhimit ka rezultuar se nga 11 rekomandime të lëna nga inspektimet e kaluara (07/2016; 08/2016), tre (3) prej tyre janë përmbushur plotësisht, dy (2) janë përmbushur përgjithësisht, katër (4) janë përmbushur pjesërisht, një (1) nuk është përmbushur dhe një (1) prej rekomandimeve nuk është vlerësuar në këtë inspektim.

Ky inspektim ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime dhe Raporti i inspektimit iu ka adresuar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, si dhe është publikuar në faqen zyrtare.

### **Inspektimi nr. 8/2018: Menaxhimi i planeve vendore të policimit, të sigurisë në komunitet dhe nismave të policimit në komunitet**

Inspektimi është realizuar bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta për vitin 2018 dhe ka mbuluar periudhën vjetore 2016-2017, si dhe gjendjen aktuale në këtë fushë të menaxhimit. Inspektimi është përqendruar në të gjitha drejtoritë rajonale policore dhe stacionet policore të kategorisë A.

Me qëllim të arritjes së objektivave strategjike, në stacionet të kategorisë A në pajtim me strukturën organizative policore dhe Procedurën Standarde të Operimit - Veprimtaria policore në sektorë bazuar në Strategjinë, Planin e Veprimit dhe metodologjinë e Policisë së Kosovës për policim në komunitet, Policia ka bërë ndarjen në sektorë të zonave të përgjegjësisë së stacioneve policore. Tek disa stacione ndarja sektoriale konsiderohet e qëndrueshme, derisa disa tjera janë në fazën e rishikimit të tyre bazuar në kriteret bazë që ndikojnë në ndarje sektoriale. Sektorët policor janë duke u ballafaquar me mungesë personeli, për dallim me atë që e përcakton Lista e Autorizuar e Personelit. Standardi i përcaktuar për qëndrim të zyrtarëve policor për së paku dy (2) vite në kuadër të sektorit, del të jetë i sfiduar për shkak të lëvizjes të personelit. Hapja e zyreve kontaktuese nëpër zonat rurale po përcillet me pengesa të natyrave të ndryshme, me gjithë faktin se disa nga sektorët e stacioneve policore kanë arritur të hapin disa sosh. Dosjet sektoriale janë duke u konsoliduar, pasi tek to janë gjetur mangësi informatash, me çka nevojitet një angazhim dhe koordinim në mes të njësive dhe institucioneve.

Lidhur me nxjerrjen dhe realizimin e planeve operative të stacioneve policore, numri i tyre për vitet 2016-2017 është pothuajse i balancuar, por ka dallime të mëdha sa i përket numrit të tyre, varësisht nga stacionet edhe pse i takojnë të njejtës kategori. Stacionet

duhet të realizojnë konceptin siç e parasheh Strategjia - Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca dhe Procedura Standarde e Operimit për Detyrat e zyrtarit policor në procesin e inteligjencës, në përdorimin e raporteve informuese dhe atyre të inteligjencës. Inspektimi tregon se stacionet hartojnë raporte analitike, ku paraqesin shtrirjen e veprimtarisë kriminale, identifikimin e pikave të nxehta, kohën, identifikimin e të dyshuarve të vepra kriminale, mënyrën e kryerjes së veprës, në mënyrë që zyrtarët policor në stacionet policore të kenë një pasqyrë më të mirë për planifikimet dhe qasjen në zonat e identifikuara. Raportet vjetore të stacioneve janë analizuar dhe në përgjithësi informatat përcillen zinxhir në hierarkinë e stacionit. Policia ka avansuar në mënyrën e mbledhjes së të dhënave mbi trendët e krimit dhe kjo bën që periodikisht të maten dhe krahasohen indikatorët e aktivitetit kriminal.

Në nivel të përgjithshëm të stacioneve policore të kategorisë A, rastet penale dhe incidentet në vitin 2017 kanë shënuar rënie në njërën anë krahasuar me vitin paraprak, ndërsa rënie ka shënuar edhe zbulueshmëria e rasteve në krahasim me vitin 2016, që paraqet një indikator në kah të kundërt me synimet. Stacionet policore janë ballafaquar më shumë me veprat penale kundër pasurisë. Masat pro - aktive të ndërmarra nga stacionet në vitin 2017 në ngritjen e sigurisë rrugore pasqyrojnë se përgjithësisht stacionet kanë rezultuar me rënie të numrit të aksidenteve krahasuar me vitin 2016. Të dhënat pasqyrojnë rënie të numrit të ekzekutimit të urdhëresave të gjykatave dhe në këtë drejtim stacionet policore duhet të analizojnë faktorët që kanë ndikuar në këtë performancë. Të dhënat mbi asistimet pasqyrojnë se stacionet vazhdojnë të jenë të ngarkuara me angazhime në dhënien e asistencës për institucione publike e private, me çka shihet e nevojshme të bëhet rishikimi i këtyre politikave, drejt fuqizimit të punës sektoriale. Në drejtim të avansimit dhe fuqizimit të partneritetit me komunitetin, stacionet janë përfshirë në aktivitete me drejtoritë komunale të arsimit, këshillat e shkollave dhe prindërve. Stacionet duhet të punojnë në përgatitjen e trajnerëve në nivel lokal për të ligjëruar në shkolla siç e parasheh Strategjia dhe Plani i Veprimit (Policia në Bashkësi). Vlerësohet se gjendja e përgjithshme e funksionimit të Këshillave Lokale për Siguri Publike është jo e kënaqshme dhe ka kërkesa për krijimin e disa KLSP-ve të reja. Kurse, lidhur me ato ekzistueset, po paraqiten probleme rreth mos interesimit të anëtarëve të tyre, për shkak të moskompensimit apo stimulimit për angazhimin e tyre. Me gjithë faktin që për implementimin e punës sektoriale nevojiten kushte pune, në praktikë del se stacionet ballafaqohen me probleme të shumta të natyrës teknike-

logjistike. Vërehen mungesa të hapësirave për punë dhe pajisjeve (kompjuter, aparate fotografike, matës të shpejtësisë së lëvizjes, alkooteste, printer, etj). Problematikë në vete është edhe mungesa e automjeteve që konsiderohen të domosdoshme për punë efikase në sektorë policor.

Ky inspektim ka rezultuar me 9 rekomandime dhe Raporti i Inspektimit iu ka adresuar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, si dhe është publikuar në faqen zyrtare.

### **Inspektimi nr. 09/2018: Menaxhimi i ankesave dhe hetimit disiplinor**

Inspektimi është realizuar bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta për vitin 2018 dhe ka mbuluar periudhën vjetore 2016-2017, si dhe gjendjen aktuale në këtë fushë. Inspektimi është përqendruar në Drejtorinë e Standardeve Profesionale dhe të gjitha njësitë rajonale të hetimeve të brendshme. Ky Inspektim ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime dhe Raporti Inspektimit iu ka adresuar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, si dhe është publikuar në faqen zyrtare.



## **IX. AKTIVITETET NË FUSHËN E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, BASHKËPUNIMIN VENDOR E NDËRKOMBËTAR, PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE ÇËSHTJEVE LIGJORE**

---

IPK gjatë vitit 2018 ka qenë i angazhuar në përmbushjen e detyrave që kanë dalë nga Planin zhvillimor strategjik 2016-2018 dhe detyra të tjera sipas nevojave të IPK-së. Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun, bashkëpunimin vendor e ndërkombëtar, planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore, IPK i ka realizuar përmes Departamentit për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim, respektivisht përmes Divizionit për Bashkëpunim dhe Informim dhe atij për Planifikim dhe Çështje Ligjore.

Departamentit për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim ka qenë i angazhuar në aspektin e planifikimeve strategjike duke përgatitur Planin vjetor dhe Planin e veprimit, pastaj përgatitjen dhe azhurnimin e Listës së analizës së riskut për IPK-në, draftimin e Planit Zhvillimor Strategjik 2019-2021 dhe Planit të veprimit, draftimit së bashku me grupe punuese të Procedurave Standarde të Operimit për menaxhimin e ankesave dhe hetimeve etj.

Angazhimet e këtij Departamenti kanë qenë të fokusuar edhe në fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë dhe institucione vendore e ndërkombëtare.

### **a) Bashkëpunimi me institucionet vendore**

Në kuadër të bashkëpunimit vendor Divizionet e lartcekura kanë pasur disa aktivitete të rëndësishme drejt fuqizimit të këtij bashkëpunimi.

Si pikë e kontaktit me institucionet vendore janë trajtuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur në adresën e IPK-së. Në bashkëpunim me departamentet e tjera janë kthyer



përgjigjet në MPB lidhur me raportimet për përmbushjen e objektivave strategjike të Planit të MPB-së dhe Qeverisë duke plotësuar matricat që janë përcjellë.

Janë trajtuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur nga Avokati i Popullit duke përfshirë edhe kërkesat për hapjen e rasteve sipas detyrës zyrtare (ex-officio) që janë identifikuar falë bashkëpunimit me Avokatin e Popullit.

Si pikë e kontaktit me Agjencinë Kundër Korrupsionit është marrë pjesë në takimet e organizuara nga kjo Agjenci që janë ndërlidhur me plotësimin e pyetësorit në kuadër të projektit PECK II si dhe draftimin e Strategjisë kundër korrupsionit 2018-2022.

Divizioni për Bashkëpunim dhe Informim ishte udhëheqës i Grupit Punuese së bashku me Divizioni për Planifikim dhe Çështje Ligjore, dhe pikë kontakti për pyetësorin për luftën kundër korrupsionit për përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit.

Pas plotësimit të këtij pyetësori i njëjti brenda afateve të caktuara kohore është përcjellë në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Divizioni për Bashkëpunim dhe Informim ka trajtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike si dhe ka raportuar te Zyra e Kryeministrit lidhur me numrin e kërkesave që janë trajtuar për vitin e kaluar.

## **b) Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun**

Varësisht sipas nevojave operative në terren, në bashkëpunim me departamente të ndryshme në kuadër të IPK-së, janë publikuar komunikata për media, janë organizuar takime ku janë pasqyruar rezultatet e arritura nga IPK-ja. Aktivitetet e deritashme që janë realizuar gjatë vitit 2018 nga IPK-ja në drejtim të fuqizimit të transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarë kanë qenë:

- publikimi i rasteve që zgjojnë interesin e opinionit publik (kryesisht përmes komunikatave për media;
- dhënia e deklaratave për mediet;
- angazhime shtesë në fushën e marrëdhënieve me publikun;
- përgjigjja në kërkesat për qasje në dokumente publike;
- përgjigjja në kërkesat e adresuara nga mediet e ndryshme në çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e IPK-së, etj.

### c) Publikimi i revistës “Integriteti”

Një ndër angazhimet e IPK-së për vitin 2018 në për fuqizimin e transparencës ishte vazhdimi i publikimit të revistës së IPK-së “Integriteti”.

Përveç informimit të brendshëm dhe atë kryesisht përmes shkrimeve të ndryshme të botuara në revistën zyrtare të IPK-së, revista “Integriteti” konsiderohet si një projekt i rëndësishëm edhe për informimin e jashtëm e sidomos të zyrtarëve të Policisë së Kosovës, por edhe partnerëve vendorë e ndërkombëtarë për angazhimet e IPK-së si dhe qytetarët e vendit.



### d) Aktivitete me qytetarë në projektin “Të Rinjtë për Drejtësi” që mbështetet nga National Center for State Courts – NCSC (SHBA).

IPK përmes Divizionit për Bashkëpunim dhe Informim ishte pjesë e panelit diskutues në ciklin e debateve publike të cilat janë mbajtur në nivelin lokal në tre komunat e rajonit të Prishtinës, përkatësisht, Drenas, Obiliq dhe Lipjan. Të pranishëm në këtë panel ishin edhe përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsionit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor.

Këto debate u mbajtën me qëllim të informimit të qytetarëve nga komunat përkatëse mbi misionin që IPK ka dhe sfidat me të cilat përballet sot IPK-ja por edhe te agjencitë e tjera.

Gjatë këtyre debateve me rininë e këtyre komunave u diskutua edhe për rolin e qytetarëve në fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Këto debate u organizuan në kuadër të fazës së tretë të projektit “Të Rinjtë për Drejtësi” në kuadër të programit “Kërko Drejtësi” që po mbështetet nga National Center for State Courts – NCSC.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve është publikuar edhe videoja promovuese e platformës “Know Your Rights” (Njih të Drejtat Tua).



Know Your Rights (Njih të Drejtat Tua), është një platformë online, me të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit ka për qëllim të promovojë të drejtat e të rinjve të moshës 16-29 vjeçare, sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

Në këtë platformë të përfshira janë edhe dy institucionet e tjera si: Inspektorati Policor i Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor ku qytetarët do të kenë mundësi të paraqesin ankesa.

#### **e) Aktivitete me qytetarë në Kuvendin Komunal të Zveçanit me Ekipin Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSBS) në Zveçan**

IPK ka realizuar edhe shumë aktivitete që kanë pasur për qëllim fuqizimin i bashkëpunimit me qytetarë, por edhe ngritjes së vetëdijes qytetare lidhur me fushë-veprimtarinë e IPK-së.

Një aktivitet i tillë me temën “Inspektorati Policor i Kosovës, roli dhe rëndësia në sundimin e ligjit në Kosovë”, është mbajtur me qytetarët e Zveçanit në ndërtesën e Kuvendit Komunal ku morën pjesë qytetarë të moshave të ndryshme.

Ky aktivitet është realizuar në bashkëpunim me ICITAP-in, Kuvendin Komunal të Zveçanit dhe EVSB-në në Zveçan.

Në bashkëpunim me ICITAP-in amerikan, Divizioni për Bashkëpunim dhe Informim ka qenë pjesëmarrës në shumë aktivitete të forumeve të sigurisë në përgjithësi e të EVSB-

ve në veçanti, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me të njëjtat lidhur me fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë.

#### **f) Bashkëpunimi me EPAC**

Divizioni ka qenë si pikë e kontaktit me EPAC duke kthyer përgjigje në kërkesat për bashkëpunim në fushën e mbikëqyrjes policore që kanë ardhur në adresën tonë.

IPK edhe këtë vit mori pjesë në konferencën profesionale të radhës të EPAC-ut e cila u mbajt në Rust të Austrisë, 22-24 Tetor 2018.



Në këtë konferencë morën pjesë mbi 30 delegacione të institucioneve të mbikëqyrjes policore dhe agjencive kundër korrupsionit nga shtete evropiane, si dhe përfaqësues nga EUROPOL dhe INTERPOL.

Në kuadër punimeve në konferencë janë diskutuar dhe trajtuar tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me fuqizimin e luftës kundër korrupsionit, fuqizimin e sundimit të ligjit si dhe rritja e bashkëpunimit në mes agjencive të ndryshme të zbatimit të ligjit, sidomos të agjencive mbikëqyrëse policore. Në kuadër të agjendës së paraparë janë mbajtur punëtori të ndryshme që në mes tjerash kanë trajtuar tema si: të drejtat e njeriut në kontekst të luftës anti-korrupsion, integriteti evropian, sistemi i ankesave, etj.

Përfaqësuesit e delegacionit të Kosovës në këtë konferencë zhvilluan takime të ndara me shumë delegacione pjesëmarrëse nga shtetet e Evropës me qëllim të njohjes dhe shkëmbimit të praktikave të mira në forcimin e sundimit të ligjit.

#### **g) Bashkëpunimi me Republikën e Maqedonisë**

Divizioni për Bashkëpunim dhe Informim ka përgatitur draft marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e mbikëqyrjes policore me Republikën e Maqedonisë. Kjo marrëveshje ka për qëllim të përmirësojë bashkëpunimin në fushën e shërbimeve të kontrollit të brendshëm në të dy vendet, me qëllim rritjen e efektivitetit së luftës kundër korrupsionit në radhët e policisë si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individit.

Kjo Draft marrëveshje e karakterit të sigurisë me vendet e rajonit, respektivisht me Republikën e Maqedonisë në fushën e kontrollit të brendshëm me kërkesën tonë është përcjellë në MPB që procedurat për të, të iniciohen dhe negociohet për nënshkrimin e tyre me Maqedoninë.

#### **gj) Bashkëpunimi me Projektin e përbashkët të BE/Këshilli i Evropës kundër Krimin Ekonomik (PECK II)**

Në kuadër të procesit të vlerësimeve në fushat e luftimit të korrupsionit, pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit që do të mbahen gjatë këtij viti nga Projekti i përbashkët i BE/Këshilli i Evropës kundër Krimin Ekonomik (PECK II), përfaqësuesi i Divizionit për Bashkëpunim dhe Informim ka marrë pjesë në takimin lansues që u mbajt në Strasbourg, Francë, nga data 19 deri me 21 shkurt 2018.

Sipas agjendës së paraparë nga ekspertët e angazhuar nga Këshilli i Evropës janë dhënë shpjegime lidhur me vazhdimin e aktiviteteve lidhur me projektin PECK II duke përfshirë agjendën e vizitave në terren sipas planifikimeve paraprake.

#### **h) Bashkëpunimi me Prokurorinë**

Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimore dhe menaxhmenti i saj kanë krijuar lidhje bashkëpunimi në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe veprave tjera penale në polici. Kjo ka ndikuar që Inspektorati Policor i Kosovës dhe

Prokuroria e Shtetit të Republikës së Kosovës të krijojnë raporte të bashkëpunimit në





luftën e dukurive negative të cilat hasen në radhët e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, e në veçanti në luftimin e korrupsionit përmes, shkëmbimit të informacioneve lidhur me dyshimin e implikimit në veprimtari penale të zyrtarëve policor.

### **i) Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës**

Bashkëpunim me Policinë e Kosovës është orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës reciproke, teknike, operative dhe mbështetëse, të paraparë edhe me legjislacionin në fuqi. Këtij bashkëpunimi i kanë prirë disa takime që janë zhvilluar për të diskutuar çështje që ndërlidhen me fushëveprimin e IPK-së.



### **j) Bashkëpunimi me ICITAP-in**

IPK vlerëson lart bashkëpunimin me ICITAP-in Amerikan, i cili është i rëndësishë së veçantë dhe ka ndihmuar IPK-në edhe në ndërtimin e kapaciteteve. Trajnimet të cilat ka ofruar ICITAP ndër vite për IPK-në kanë qenë mëse të nevojshme dhe të qëlluara për të arritur përmbushjen e misionit të IPK-së. Ndër trajnimet e rëndësishme të realizuara gjatë vitit 2018 ishte "Intervistimi forensik" dhe "Vetëdijesimi për sigurinë kibernetike", për hetuesit e IPK-së. Këto trajnime të rëndësishme janë vazhdimësi e mbështetjeje të vazhdueshme drejt ndërtimit dhe fuqizimit të kapaciteteve operative të mekanizmave të sigurisë siç është IPK dhe pason edhe donacionet e shumta të pajisjeve për vëzhgim të realizuara nga ICITAP.



### **k) Bashkëpunimi me projektin 'Avancimi i të Drejtave të Njeriut në Policinë e Kosovës' i bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës në kuadër të "Mekanizmit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë",**

Divizioni për Bashkëpunim dhe Informim ka shërbyer si pikë kontakti por edhe është caktuar pjesë e Komitetit Drejtues në kuadër të projektit "Avancimi i të drejtave të njeriut në Policinë e Kosovës" ku si institucion përfitues është edhe IPK-ja.

Projekti 'Avancimi i të Drejtave të Njeriut në Policinë e Kosovës' nisi zyrtarisht në janar 2018. Projekti bashkë-financohet nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës në kuadër të "Mekanizmit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë", qëllimi kryesor i të cilit është të avancojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga policia dhe fuqizimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të pavarur policor.

Në kuadër të këtij projekti ka pasur shumë aktivitete dhe takime që janë mbajtur me zyrtarët e këtij projekti. Ky projekt i Këshillit të Evropës ka për qëllim përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga policia dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të pavarur policor.

Projekti po përkrahë përpjekjet që synojnë luftimin e keqtrajtimit dhe mosndëshkimin në polici përmes përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional që siguron mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga policia, duke forcuar kapacitetin e policisë për të zbatuar standardet evropiane të të drejtave të njeriut në punën e tyre të përditshme dhe duke përmirësuar më tej sistemin e hetimit të pavarur dhe efektiv të rasteve të dyshuara të keqtrajtimit.

Në kuadër të këtij projekti gjatë muajit qershor janë organizuar punëtori që kanë pasur si qëllim përmirësimin e kuadrit të akteve nënligjore me qëllim rritjen e pavarësisë, hetimit procedurat dhe efektivitetit duke draftuar tekstin e Udhëzimit Administrativ të propozuar për Ankesat në përputhje me parimet e EPAC-ut.

Përveç kësaj dhe aktiviteteve të tjera DBI ka qenë si pikë e kontaktit me këtë projekt edhe lidhur me planifikimet për organizimin e vizitës studimore në Dublin – Irlandë që është realizuar në nëntor të këtij viti.

Me objektivin e përgjithshëm për të avancuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga policia dhe për të fuqizuar më tej sistemin e kontrollit të





pavarur të policisë, projekti angazhoi dy konsulentë ndërkombëtarë dhe një konsulent vendor që t'i asistojnë në mënyrë specifike IPK-së që të zhvillojë një strategji të trajnimit, program të trajnimit dhe module të trajnimit që u prezantuan gjatë tre sesioneve 2-ditore të Grupit Punues që u mbajt në Prishtinë.

Nën udhëheqjen e konsulentëve, IPK ka krijuar një Grup Punuese për Strategjinë e Trajnimit për të:

- vlerësuar në mënyrë tërësore nevojat për trajnim të institucionit, dhe;
- dizajnuar dhe zhvilluar një strategji dhe program të trajnimit.

Procesi i Vlerësimit të Nevojave për Trajnim u bë relativisht brenda një afati të shkurtër, gjatë muajve tetor dhe nëntor 2018 u përgatit edhe Strategjia për Trajnime e IPK-së 2019-2021.

### **1) Bashkëpunimi me misionin e OSBE-së**

DBI ka qenë si pikë e kontaktit edhe me misionin e OSBE-së në Kosovë duke bashkërenduar aktivitetet e përbashkëta që kanë përfshirë trajnimet e organizuara nga ky mision ku kanë marrë pjesë zyrtarët e IPK-së .

Me mbështetjen e OSBE-së është realizuar një punëtori dy ditore në Prishtinë për draftimin respektivisht caktimin e objektivave strategjike për Planin e ri strategjik. Gjithashtu, ky mision ka kontribuar në grupe punues me angazhimin e ekspertëve si dhe ka mundësuar për IPK-në organizimin e një punëtorie tri ditore në Durrës të Shqipërisë për finalizimin e Planit Zhvillimor Strategjik 2019-2021.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka vazhduar përkrahjen për fuqizimin e IPK-së, duke kontribuar në mënyrë direkte në ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit të




IPK-së. IPK pritet të kompletoj dhomën e dëshmive konform standardeve të kërkuara, falë një donacioni nga misioni i OSBE-së, projekt, i cili është në realizim e sipër. Misioni i OSBE-së ka organizuar edhe trajnime me ekspertë kundër krimeve financiare nga “Guarda di Financa”, ku kanë marrë pjesë disa hetues të IPK-së.

## X. SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme (DFSHP) në IPK ka rol mbështetës dhe shumë të rëndësishëm në menaxhimin e buxhetit, menaxhimin e burimeve njerëzore si dhe menaxhimin e sistemeve të teknologjisë informative dhe shërbimeve logjistike në arritjen e objektivave të IPK-së.

Në tabelën dhe diagramin e mëposhtëm, janë prezantuar të dhënat finale buxhetore të IPK-së për vitin fiskal 2018:

Kategoria Ekonomike	Buxheti Final	Realizimi	Përqindja
<b>Paga dhe Mëditje</b>	926,063.05	926,063.05	100.00
<b>Mallra dhe Shërbime</b>	248,875.00	200,570.77	80.59
<b>Shpenzime Komunale</b>	6,800.98	3,158.54	46.44
<b>Projekte Kapitale</b>	6,223.00	5,497.20	88.34
<b>Totali</b>	<b>1,187,962.03</b>	<b>1,135,289.56</b>	<b>95.57</b>



Sipas të dhënave të prezantuara nga Divizioni i Burimeve Njerëzore, nga punonjësit e IPK-së janë ndjekur 14 trajnime, me qëllim të ngritjes profesionale të punonjësve operativ dhe administrativ.

Nga tabelat në vijim shihet llojllojshmëria e trajnimeve, të cilat kanë qenë shumë përmbajtësore dhe specifike për punën, detyrat dhe përgjegjësitë që kanë punonjësit operativ dhe administrativ të IPK-së, për të arritur rezultate sa më efektive në zbatimin e mandateve të tyre ligjore.

<b>TRAJNIMET/ STAFI OPERATIV</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emri i trajnimit</b>	<b>Organizata</b>	<b>Nr. zyrtarëve</b>
1	Krimet Kibernetike	European Union	3
2	Intervistim Forenzik	ICITAP-PK	2
3	Forcimi i kapaciteteve të hetimit penal kundër korrupsionit me partnerët e drejtësisë penale në Mitrovicë	EULEX	1
4	Trajnimi Bazik Hetimi i Krimit	AKSP	2
5	Trajnimi për Trajner të Trajnerëve për Zbatim të Programit Fushor	AKSP	2
6	Trajnimi i Vëzhgimit-Niveli i Parë te kryer këtë trajnim.	AKSP	2
7	Kursi Bazik për Qendra e Ndalimit	AKSP	2
8	Kursi Komunikimi Jo-Verbal dhe Menaxhimi i Stresit	AKSP	2
9	Trajnimi i Avancuar i Hetimit të Krimit	AKSP	2
10	Hetimi i Vrasjes	AKSP	1
11	Përkrahja e mëtejme e arsimit në siguri publike në Kosovë KS 14 IB JH 01	OSCE/AKSP	24
12	Trajnim në hetimin e krimeve të urrejtjes në bashkëpunim	OSCE/AKSP	15
13	Cyber Security Aëareness Cours	ICITAP	58
14	Anti-Corruption Training For Laë Enforcement Agencies	OSCE	3

<b>TRAJNIMET/ STAFI ADMINISTRATIV</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emri i Trajnimit</b>	<b>Organizata</b>	<b>Nr. zyrtarëve</b>
1	Krimet Kibernetike	European Union	1
2	Motivimi dhe udhëheqja e punonjësve	IKAP	2
3	Ankimimi në Çështjet e Disiplinës në Shërbimin Civil	IKAP	2
4	Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore.	IKAP	1
5	Trajnimin në fushën Teknologji Informative në temën/ Microsoft Visio & Microsoft Publisher	IKAP	2
6	Trajner/e/ i- IKAP-it	GIZI/ Gjerman	1
7	Aftësitë Menagjuese/Stili i Udhëheqjes	IKAP	2
8	Trajnim hyrës për BE:	IKAP	2
9	Rëndësia e Burimeve Njerëzore në Menaxhimin Strategjik të buxhetit dhe Prokurimi	FLSA Kroaci	2
10	Managment and resource information managment sistem e-procurement	ICITAP	3
11	Cyber Security Awareness Cours	ICITAP	21
12	Menaxhimi i ciklit të projekteve MCP	IKAP	2
13	Microsoft Access	IKAP	2
14	Microsoft Office(Outlook-Power Point	IKAP	1



Institucioni i Avokatit Popullit në Kosovë  
Institucija Ombudsmena në Kosovë  
Ombudsgesam Institutet in Kosovo  
Kosova Halkin Avukatı Enstitüsü





INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA  
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO



**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA  
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:  
AKO MISLITE DA SU VAŠA PRAVA PREKRŠENA OD STRANE POLICAJACA  
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:  
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,  
REPORT IN *BLUE LINE*:**

**RAPORTONI PA PAGESË  
IZVESTI BESPLATNO U  
FREE OF CHARGE**



**080003333**

**Së bashku për një polici profesionale  
Zajedno za profesionalnu policiju  
Together for professional police**

IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE  
PIK OSIGURAVA POTPUNU TAJNOST U TRETIRANJU INFORMACIJAMA  
PIK OFFERS FULL CONFIDENTIALITY IN TREATING THE INFORMATION